



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Prishtinë, 04 maj 2020

Përshkrimi i detyrave për shërbimet e Dizajnit Grafik/Infografikës

Qëllimi i kryerjes së shërbime

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është Institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Republikën e Kosovës. Institucioni, sipas mandatit ligjor është duke i dhënë fokus të veçantë kryerjes së auditimeve me qëllim që të promovojnë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

ZKA kryen auditime të rregullsisë dhe auditime të performancës, ku në kuadër të tyre përfshihen fusha me interes shoqëror, ekonomik, të TI etj dhe qëllimi kryesor i angazhimit/ kontraktimit të shërbimeve për Dizajn Grafik është për të ndihmuar zyrën që të rris cilësinë dhe lehtësinë e transmetimit të informatave për institucionet dhe publikun përgjithësisht.

Eksperti i përzgjedhur duhet të ofrojë mbështetje teknike për njësitë audituese për zhvillimin e dizajnit grafik në raportet e prodhuara nga ZKA. Përgjegjësia e ekspertit është të hartojë dizajne grafike dhe modele standarde sipas standardeve profesionale dhe elementeve më inovative të dizajnit grafik dhe ate në tri gjuhë, shqipe angleze dhe serbe.

Detyrat dhe shërbimet e caktuara:

- Punimi i dizajnëve dhe punëve të tjera grafike/vizuale për krijimin e identitetit, konceptit dhe përquarjes së mesazhit apo simbolikës së raporteve të auditimit sipas përmbajtjes së tyre.
- Përgatit të gjitha projektet e dizajnit, që nga konceptimi deri te shpërndarja;
- Përcakton imazhet, fontet dhe formatet duke përdorur softuerin e dizajnit grafik;
- Hulumton ide për të paraqitur koncepte dhe për të reklamuar produktet / shërbimet ne rrjetet sociale, webfaqe, televizione, gazeta etj;
- Përdor teknikat e tipografisë;
- Krijon versione të ndryshme të dizajneve, logove, koncepte per broshura, prezantime, flyer-a, fletepalosje etj ;

- Asiston me realizimin dhe përgaditjen e videove dhe fotografive;
- Eshtë i/e interesuar të mësojë dhe të përshtatet në ekipin e kompanisë.
- Kryen edhe detyra të tjera, të ndërlidhura me dizajnin grafik dhe që paraqiten sipas nevojave dhe rasteve të caktuara.

Përgjegjësitë:

Eksperti i angazhuar për kryerjen e detyrave, do të punoj me zyrtarët përgjegjës të njësisë organizative për punë audituese dhe dizajni grafik/ infografika për secilin raport finalizohet në koordinim të përbashkët ndërmjet tyre.

Varësisht prej nevojave për kryerjen e punëve dhe numrit të raporteve të auditimit, eksperti i angazhuar duhet të punoj nën presion kohor dhe duke i respektuar kërkesat dhe afatet e parashtruara nga zyrtarët përgjegjës.

Të gjitha shërbimet e kryera në dizajnin grafik mbeten në pronësi dhe autorësi të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Kualifikimi dhe ekspertiza:

- Diplomë universitare për dizajn grafik;
- Minimum dy (2) vite përvojë të punës të dokumentuar në prodhim të dokumenteve që përfshijnë elemente të dizajnit grafik nga fillimi e deri tek produkti i botuar / printuar

Aftësitë tjera:

- Njohuri të shkëlqyera të programeve kompjuterike Adobe Package (Adobe Photoshop, Adobe Illustrator, Adobe Indesign, Corel Draw, Adobe Acrobat Pro, etj)
- Aftësi për të realizuar dhe komunikuar qartë konceptet dhe idetë e dizajnit;
- Shkathtësi të mira komunikuese;
- Te mendoje në mënyrë kreative për të nxjerre ide dhe koncepte të reja;
- Të jenë kreativ dhe inovativ;

Kandidatët duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- dëshmitë për kualifikimin shkollor,
- dëshmitë për përvojën e punës, dëshmitë për kualifikimet tjera nëse ka dhe së paku dy referenca për punët e deritanishme të kryera;
- kopjen e letërnjoftimit.